

VENDIM
Nr.522, datë 8.8.2007

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË NJË KONTIGJENTI USHTARAK SLOVEN
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit të një kontingjenti ushtarak sloven përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë – Porti i Durrësit – Aeroporti Rinas, në periudhën 10 gusht – 10 shtator 2007.

2. Kalimi transit do të bëhet i ndarë në faza, si më poshtë vijon:

- Në datën 11.8.2007, do të vijnë në portin e Durrësit, 10 (dhjetë) kamionë të rëndë ushtarakë për të shkuar, në të njëjtën ditë, në Kosovë.

- Në datën 16.8.2007, do të kalojnë 2 (dy) autokolona, të përbëra nga 17 (shtatëmbëdhjetë) dhe 11 (njëmbëdhjetë) mjete, të cilat do të imbarkohen në anije në portin e Durrësit. 22 (njëzet e dy) shoferë do të shkojnë në Aeroportin e Rinasit për të fluturuar për në Slloveni, ndërsa pjesa tjetër e shoferëve do të rikthehen në Kosovë, me një autobus sloven, të shoqëruar nga një kamion i rëndë i mirëmbajtjes, i cili do të jetë pjesë e autokolonës së dytë.

- Në datën 23.8.2007, do të kalojnë 2 (dy) autokolona, të përbëra nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) mjete, të cilat do të imbarkohen në anije, në portin e Durrësit. Shoferët e mbetur do të shkojnë në aeroportin e Rinasit, për të fluturuar për në Slloveni. Kamioni i rëndë i mirëmbajtjes do të rikthehet në Kosovë.

- Në datën 30.8.2007, do të kalojnë 2 (dy) autokolona të përbëra nga 18 (tetëmbëdhjetë) dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) mjete, të cilat do të imbarkohen në anije në portin e Durrësit. 68 shoferë do të shkojnë në Aeroportin e Rinasit, për të fluturuar për në Slloveni. Kamioni i rëndë i mirëmbajtjes do të rikthehet në Kosovë.

- Në datën 3.9.2007, do të mbërrijnë në portin e Durrësit, 9 (nëntë) kamionë të rëndë ushtarakë, të pangarkuar, për të shkuar, në të njëjtën ditë, në Kosovë.

- Në datën 6.9.2007, do të kalojnë 3 (tri) autokolona, të përbëra nga 18 (tetëmbëdhjetë) mjete secila, të cilat do të imbarkohen në anije, në portin e Durrësit. Shoferët e mbetur do të shkojnë në Aeroportin e Rinasit, për të fluturuar për në Slloveni.

3. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë për marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

4. Kontingjenti sloven gjatë itinerarit të lëvizjes, të shoqërohet nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha